

PËR: Panelin për Ankesa dhe Parashtrresa (PZAP)
NGA: Partia Demokratike e Kosovës (PDK)
Lënda: Kërkesë për Rishqyrtimin e Vendimit Anr. 147/2025

Partia Demokratike e Kosovës me datë 23.01.2025, ka parashtruar ankesë kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, në të cilën ka pretenduar se:

- Më datë 21 janar 2025, Asistenti i Zyrës Administrative të Lëvizjes Vetëvendosje, Qendra në Sharr, Komuna e Dragashit, z. Asri Qusaj, ka postuar një status në rrjetin social Facebook, në të cilin postim, i njëjti përdorë gjuhë fyese dhe denigruese kundrejt partive kundërshtare.
Provë: Postimi i z. Asri Qusaj në rrjetin social Facebook, e cila përmban gjuhë nxitëse dhe urrejtëse;
- Konkretisht, i njëjti në këtë postim ka deklaruar se: *"M'u që në saba dhe me i thonë vetes: "Bravo, Asri, je milioner, krejt punët i ke në terezi"- është njëfarë motivimi momental , që ndoshta më lumturon e më jep pozitivitet. Por mbaron gjithcka, kur veq kthelmi në tjetrin krah.*
E, njëjtë po më duken edhe këto takime fshat më fshat të partive LyDyKy e PyDyKy. Bartin njerëz nga fshatra të tjerë, vetëm sa për numër, sa për t'u motivuar e për t'u lumturu pak. Por këta as anën s'po e ndërrojnë - vec sytë po i mshelin."
- Përmbajtja e këtyre deklaratave pamëdyshje përbën përdorim të gjuhë fyese dhe denigruese ndaj subjekteve kundërshtare politike, ku i njëjti Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) dhe Lidhjes Demoraktike të Kosovës (LDK), i referohet me gjuhë denigruese si "LyDyKy e PyDyKy".

PRETENDIMET ANKIMORE:

- PDK vlerëson se në veprimet e z. Asri Qusaj janë konsumuar të gjitha elementet e veprimit të ndaluar, të përcaktuar në nenin 34, par. 1, nënpar. 1.11 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.
- Si më sipër, përmes përdorimit të gjuhës fyese dhe denigruese, z. Asri Qusaj, PDK konsideron se janë tejkaluar kushtet që gjatë periudhës së fushatës, veprimet e subjekteve politike të jeni në një atmosferë të tolerancës, demokracisë, paqes dhe respektit për sundimin e ligjit, e cila për pasojë ka denigrimin dhe përkeqësimin e klimës në të cilën duhet të zhvillohet gara zgjedhore dhe mund të rrisë tensione mes subjekteve politike.

PRAKTIKA E PZAP NË RASTET ANALOGE:

6. PZAP më datë 20.01.2025, ka nxjerrë vendimin A.nr.59/2025, përmes të cilës e ka aprovuar ankesën e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës, ashtu që subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, i ka shqiptuar dënim me gjobë në lartësi prej 3,500.00€.
7. Në arsyetimin e këtij vendimi, pikërisht për përdorimin e këtyre fjalëve nga Kryeministri i Kosovës z. Albin Kurti, ndër të tjerash PZAP ka vendosur standardin se përdorimi i gjuhës nxitëse ndaj kundërshtarëve politik ka për qëllim ofendimin, denigrimin dhe njëherit shprehin ngjyrimë përçmuese ose nënvlerësuese dhe gjithnjë sipas PZAP përdorimi i kësaj gjuhe konsiderohet si përkeqësim i klimës në të cilën duhet të zhvillohet gara zgjedhore dhe njëherit mund të rrisë tensione mes subjekteve politike.

PËRFUNDIMI:


8. Si më sipër, në bazë të pretendimeve të elaboruara në këtë ankesë dhe duke marrë për bazë shkeljen e rregullave zgjedhore nga ana e z. Asri Qusaj, nga PZAP kërkojmë që të nxjerrë vendim me të cilën do të aprovoj si të bazuar ankesën e PDK-së dhe ndaj subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, t'i shqiptoj dënim me gjobë.

VENDIMI KONTESTUES:

9. PZAP brenda afatit ligjor ka nxjerrë vendimin A.nr.147/2025, përmes së cilës ka refuzuar e subjektit politik PDK si të pabazuar, duke konstatuar se nuk është arritur të argumentohet koha e shkeljes së supozuar.
10. Sa më sipër, në mbështetje të par. 4 të nenit 118 të LZP-së, PDK parashtron këtë kërkesë për rishqyrtim, mbi bazën e prezantimit të fakteve të reja, respektivisht postimin e z. Asri Qusaj, në të cilën argumentohet fakti i pakontestueshëm se i njëjti këtë shkelje e ka kryer më datë 21 janar 2025, në ora 22:43, ndërsa ankesë është dorëzuar në afatin e përcaktuar në nenin 118, par. 1 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme..
Provë: Postimi i z. Asri Qusaj në rrjetin social Facebook, e postuar më datë 21 janar 2025, në ora 22:43/h;
<https://www.facebook.com/asri.qusaj/posts/pfbid0E4KvLbSxPUQxy8hdWj6bXGwAVjGMkLpdWoPp5LZCcD4oPVLt2vxHMk45gYMS6r7Al>
11. Andaj, PDK mbi bazën e prezantimit të fakteve të reja, ka argumentuar se ankesa A.nr.147/2025 e parashtruar më datë 23 janar 2025, ka qenë e afatshme dhe nga PZAP kërkojmë që të shqyrtoj ankesën në merita dhe përkitazi me këtë ankesë dhe ndaj subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, t'i shqiptoj dënim me gjobë.

Përfaqësuesi i autorizuar,

Av. Faton Fetahu



Asri Qusaj's Post



Asri Qusaj

January 21 at 10:43 PM · 🌐

M'u qu në saba dhe me i thonë vetes: "Bravo, Asri, je milioner, krejt punët i ke në terëzi" – është njëfarë motivimi momental, që ndoshta më lumturon e më jep pozitivitet. Por mbaron gjithçka, kur veq kthehem në tjetrin krah. 🤔

E, njëjtë po më duken edhe këto takime fshat më fshat të partive LyDyKy e PyDyKy. Bartin njerëz nga fshatra të tjerë, vetëm sa për numër, sa për t'u motivuar e për t'u lumturu pak. Por këta as anën s'po e ndërrojnë – veç sytë po i mshelin.



64



Like



Share

